ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
KOMISIONI I PROKURIMIT TË KOSOVËS / KOMISIJA ZA NABAVKE
Nr/Br. 20/17
Date/Datum 20.01.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: *Ministria e Administratës Publike*

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **202 / 16 / 118 / 211**

Sa i përket tenderit për **Mirëmbajtjes teknike ne ndërtesat qeveritare, Lot 1, 2 dhe 3**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

N.P.N. 'Uni-Project'
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rexhep Krasniqi, pn
(Adresa)
Prishtine — *10000*
(Vendi) — *(Kodi postar)*
044 160 619
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Zt. Besnik Vrella
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
info@uniproject.org
(Adresa elektronike)

20 / 01 / 2017
(Data e parashtrimit të ankesës) — *(Nënshkrimi dhe vula)*

NDËRMARRJA PRIVATE NDËRTIMORE UNI-PROJECT PRISHTINË

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____
(Emri i avokatit)

_____
(Adresa e plotë)

_____ _____
(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____
(Adresa elektronike)

_____ _____
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi per kontrate është bere me datën 12.12.2016 kurse afati i fundit per dorëzimin e tenderëve ka qene 28.12.2016, ora 14:00.

Kriteri per vlerësimin e ofertave është: çmimi me i ulte

Kompania 'Uni Project' ne afatin e parapare kohor ka parashtruar pyetje ne Autoritetin Kontraktues per te kerkuar sqarim lidhur me ceshtjen e referencave dhe kontratave mirëpo nuk është ofruar asnjë përgjigje duke bere shkelje administrative – ligjore nga ana e Ministrisë se Administratës Publike.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [x] **Jo** [ ]

Është organizuar procesi i hapjes publike te ofertave nga Autoriteti Kontraktues dhe ne këtë drejtim nuk kemi vërejtje lidhur me procesin e hapjes

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

Kompania 'Uni-Project', me datën 11 / 01 / 2017, ka parashtruar 'Kërkesën per Ri-shqyrtim' ne Ministrinë e Administratës Publike duke prezantuar argumentet ligjore qe si Operator Ekonomik pjesëmarrës, i kemi plotësuar te gjitha kërkesat dhe kushtet e parashtruara te Autoritetit Kontraktues per te na shpallur fitues i Lotit 1, 2 dhe3 te tenderit per mirembajtje teknike ne ndërtesat qeveritare, Lot 1, 2 dhe Lot 3.

Ne 'Kërkesën per Rishqyrtim' kemi parashtruar argumente te mjaftueshme ligjore lidhur me mos plotësimin e kushteve te përcaktuara nga O.E i shpallur fitues ngase ky O.E ka ofruar kontrata te punës qe punojnë ne MSS dhe ne kompani tjera private dhe publike (Kompania 'Rexha' dhe 'PTK', si dhe shkeljet tjera ligjore duke përfshirë shkeljen e Vendimit te Qeverise se Kosovës per pagën minimale si dhe mos trajtimin e O.E 'MSS' si Oferte abnormalisht te ulte ne baze te nenit 3 te Rregullës B57.

Autoriteti Kontraktues – Ministria e Administratës Publike është përgjigjur duke ofruar argumente jo

ligjore dhe jo përmbajtesore ne te gjitha pretendimet tona ankimore.

Ne asnjë rrethane ligjore, përgjigja e Autoritetit Kontraktues nuk është bindëse sepse nuk e ka trajtuar Ofertën e O.E 'MSS' per Lot 1, 2 dhe Lot 3 si Oferte abnormalisht te ulte sipas nenit 3 te Rregullës B57 edhe pse oferta financiare e këtij O.E është mbi 30 % me e lire sesa Kompania 'Uni Project', e radhitur si e dyta ne renditjen e Raportit te procesit te vlerësimit te ofertave.

Gjithashtu, Autoritetit Kontraktues ka heshtur kur kemi potencuar si argument ligjor qe ne planin e menaxhimit te kontratës se O.E te shpallur fitues 'MSS' ne organigramin e Kompanisë nuk është ofruar minimumi i kerkuar prej 10 punëtoreve per LOT 1.

Duke u nisur nga fakti qe Ministria e Administratës Publike ka dështuar te ofroje kundër argumente ligjore me arsyetim ligjore, atëherë Kompania 'Uni-Project' detyrohet qe nëpërmjet parashtrimit te Ankesës ne Organin Shqyrtimit te Prokurimit te depozitoje Ankesën kundër Vendimit te MAP ne Refuzimin e 'Kërkesës per Rishqyrtim'

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Kompania 'Uni-Project', pas analizimit dhe studimit te dokumenteve relevante te Autoritetit Kontraktues dhe pas Vendimit te saj per shpalljen e fitueseve per Lot 1, 2, dhe Lot 3 per tenderin per mirembajtje teknike ne ndërtesat qeveritare konsideron se Autoriteti Kontraktues – Ministria e Administratës Publike, ka bere shkelje te dispozitave ligjore te Ligjit te Prokurimit Publik te Kosovës.

Dispozitat e shkelura nga ***Autoriteti Kontraktues – Ministria e Administratës Publike,*** janë mese vijon:

- *Është shkelur neni 59, i Ligjit te Prokurimit Publik;*
- *Është shkelur neni 61, i Ligjit te Prokurimit Publik*
- *Është shkelur neni 1, i Ligjit te Prokurimit Publik (qëllimi)*
- *Është shkelur neni 69 – 72, i Ligjit te Prokurimit Publik (aftësitë teknike)*
- *Është shkelur neni 3, i Rregullës per Çmimet abnormalisht te ulta; dhe*
- *Është shkelur neni 6, paragrafi 1, i Ligjit te Prokurimit Publik*

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Kompania 'Uni-Project', pas analizimit te teresishem te dokumenteve relevante te Tenderit per **mirembajtje teknike ne ndërtesat qeveritare per Lot 1, 2 dhe Lot 3,** konstaton dhe konsideron se Autoriteti Kontraktues – Ministria e Administratës Publike, ka bere shkelje esenciale dhe substanciale te dispozitave ligjore te kornizës ligjore per prokurim publike duke mohuar te drejtat ligjore te Kompanisë sonë ne fitimin e kontratës publike ne mënyrë te rregullte dhe ligjore.

Pretendimet tona ankimore te drejtuara per shqyrtim tek Paneli Shqyrtues i Organit Shqyrtues te Prokurimit janë te njëjta si me pretendimet ankimore te drejtuara Autoritetit Kontraktues nëpërmjet Kërkesës per Ri-shqyrtim duke detajizuar shkeljet esenciale te Autoritetit Kontraktues.

Pikat e Ankesës per shkeljet e pretenduara te Autoritetit Kontraktues *janë te prezantuara si me vijon*:

1. Autoriteti Kontraktues, me datën 6.01.2017, nëpërmjet e-mailit zyrtar njofton Kompaninë 'Uni-Project' me Eliminim nga konkurrenca nëpërmjet dorëzimit te Letrës se Tenderuesit te Pasuksesshëm dhe ne te njëjtën date publikon Njoftimin per Dhënie te Kontratës ne Portalin e KRPP-se me ane te se cilës është shpallur O.E fitues per Lot 1, 2, dhe 3' (**shih fakt nr. 1 – Letra per Tenderuesin e pasuksesshëm dhe Njoftimi per Dhënie te Kontratës**);

2. Kompania 'Uni-Project', pas publikimit te Njoftimit per Dhënie te Kontratës, me datën 11 / 01 / 2017, pergadit dhe dorëzon Kërkesën per Ri-shqyrtim tek Autoriteti Kontraktues duke shprehur mos-pajtimin per arsyet e eliminimit.

   Kërkesa per Ri-shqyrtim, është përgatitur, nënshkruar dhe dorëzuar zyrtarisht duke përdorur Formularin per Kërkese per Ri-shqyrtim duke e protokolluar zyrtarisht ne Ministrinë e Administratës Publike (**shih fakt nr. 2 – Kërkesa per Rishqyrtim, e datës 11 / 01 / 2017**);

3. Autoriteti Kontraktues – Ministria e Administratës Publike, me datën 13 / 01 / 2017, refuzon Kërkesën per Ri-shqyrtim duke mos ofruar asnjë fakt përmbajtjesor, te detajizuar dhe ligjor ne refuzimin e pretendimeve tona ankimore (**shih fakt nr.3 – Refuzimi i Kërkesës per Ri-shqyrtim, e datës 13 / 01 / 2017**);

4. Kompania 'Uni-Project' nuk i konsideron si valide dhe ligjore konstatimet e MAP-it se nuk ka pasur nevoje per te bere hetim, ashtu siç kërkohet me nenin 3 te Rregullës B57 per çmimin abnormal te ulte per arsye se O.E i shpallur fitues 'MSS' ka ofruar çmim mbi 30 % me te lire se sa Kompania e dyte (Uni Project) ne renditjen e raportit te vlerësimit te ofertave dhe se ka pasur obligim ligjor te filloje procedurën per trajtimin e ofertës se 'MSS' si çmim abnormalisht te ulte dhe te refuzoje Ofertën e tille;

5. Kompania 'Uni-Project' nuk i konsideron valide dhe ligjore konstatimet e Ministrisë se Administratës Publike per Vendimin e Qeverise se Kosovës per pagën minimale per arsye se disa kontrata te personelit inxhinierike te propozuar te O.E te shpallur fitues 'MSS' kane pagën 150 euro netto, qe i bie se paga e tyre brutto është 161.00 Euro, pra me pak se 170.00 Euro sa kërkohet me Ligj;

6. Kompania 'Uni Project' e konsideron kundërligjore heshtjen e Ministrisë se Administratës Publike ne pretendimin tone ankimore qe O.E i shpallur fitues 'MSS' ka shkelur ligjin e punës duke ofruar personel per orarin zyrtar te punës (08.00 – 16.00) qe ne te njëjtën kohe punojnë si per 'MSS', ashtu edhe per Kompaninë 'Rexha' dhe ne Post – Telekom te Kosovës.

   Veprimi i tille i O.E 'MSS' konsiderohet kundërligjor dhe ne kundërshtim te plote me Ligjin e Punës dhe si e tille është dashur te trajtoje këtë Oferte si Oferte te papergjegjeshme; dhe

7. Autoriteti Kontraktues – Ministria e Administratës Publike, ka shkelur dispozitat ligjore te LPP-se qe nuk ka ofruar sqarime konkrete gjate procesit te prokurimit ne baze te kërkesës se Kompanisë 'Uni Project' per te sqaruar ceshtjen e 'kontratave te natyrës se ngjashme' dhe ne arsyetimin e dhënë per këtë pretendim ankimor ne Kërkesën per Ri-shqyrtim është i pabazuar dhe kundërligjor.

Shënim:
Shih meposhte argumentet ligjore – pretendimet ankimore te dorëzuara nëpërmjet Kërkesës per Ri-shqyrtim qe ne pajtim me Rregullat e Reja te Parashtrimit te Ankesave, paraqiten edhe ne Ankesën drejtuar Organit Shqyrtues te Prokurimit per shqyrtim, shoshitje dhe argumentim me arsyetim ligjor para marrjes se Vendimit përfundimtar nga anëtarët e Panelit Shqyrtues te Organit Shqyrtues te Prokurimit Publik.

8. Autoriteti Kontraktues – Ministria e Administratës Publike, ka shkelur Rregullën nenin 3.1 te dhe nenin 3.2 te B57 Rregullat per trajtimin e çmimit abnormalisht te ulte per arsye se O.E fitues 'MSS' per Lot 1, Lot dhe Lot 3 është shpallur fitues edhe pse Oferta financiare e këtij O.E konsiderohet çmim abnormalisht i ulte;

Ne baze te nenit 4 per Rregullat per Tenderët – Jo-normalisht te Ulte, Autoriteti Kontraktues gjegjësisht Departamenti i Prokurimit është dashur te aplikoje procedurën 'inter partes' qe te filloje një hetim dhe shqyrtim te te gjitha elementeve te Ofertës financiare te O.E fitues 'MSS' per te konstatuar ligjërisht dhe zyrtarisht nëse Oferta e O.E 'MSS' konsiderohet abnormalisht e ulte ose oferte financiare me çmim te treguar per Lot 1, Lot 2 dhe Lot 3.

Departamenti i Prokurimit pranë Autoritetit Kontraktues nuk e ka aplikuar procedurën 'inter partes' edhe pse ka pasur obligim ligjor ne baze te nenit 61 te Ligjit te Prokurimit Publik dhe ne baze te nenit 3.1 dhe nenit 3.2 te Rregullave per trajtimin e çmimit abnormalisht te ulte per te vërtetuar dhe konstatuar çmimin e tregut te sherbimeve per mirembajtje teknike por vetëm formalisht ka shpallur fitues O.E 'MSS' duke bere shkelje te nenit 61 te LPP-se dhe duke i pamundësuar Kompanisë 'Uni Project' ne vlerësimin e drejte te ofertës sonë qe kemi ofertuar ne baze te çmimit te tregut (**shih fakt nr. 4 – neni 3 dhe neni 4 i Rregullave per trajtim te çmimit abnormalisht te ulte);**

9. Ne nderlidhshmeri, me piken 8 te kësaj Kërkese per Ri-shqyrtim, Oferta financiare per Lot 1 e O.E fitues është 33.47 % me e lire sesa oferta financiare e Kompanisë 'Uni Project kurse per Lot 2 është 34.08 % me e lire sesa oferta financiare e Kompanisë 'Uni Project' dhe per Lot 3 është 32.48 % me e lire sesa oferta financiare e Kompanisë 'Uni Project'.

   Duke marre parasysh përqindjet (%) ndërmjet ofertës se O.E fitues dhe Kompanisë 'Uni Project' e dranguar si e dyta me radhe konstatohet se Oferta e Kompanisë 'MSS' e përmbush kriterin e parapare me nenin 3.1 dhe 3.2 te Rregullave per trajtimin e çmimeve abnormalisht te ulëta dhe si te tilla duhet te refuzohen si oferta te papergjegjeshem, ashtu siç parashihet edhe me nenin 61 te Ligjit te Prokurimit Publik te Kosovës;

10. Pas shikimit te dokumentacionit te ofertës se OE MSS te propozuar per kontrate, Kompania 'Uni Project' ka vërejtur se te Organigrami (struktura e stafit menaxhues per këtë kontrate) per LOT 1 ka prezantuar vetëm Menaxherin e Lot-it mirëpo JO edhe stafin zbatues (4 inxhiniere dhe 6 punekryes). Mungesa e prezantimit te 10 punëtorëve per LOT 1 ne kuadër te Propozimit teknike te OE MSS, përben mospërmbushje te detyrimeve te dala nga Specifikacionit teknik i detyrueshëm.

    Poashtu ne ofertën e tije OE MSS ka prezantuar se do te kryeje punën me 3 ndërrime mirëpo nuk ka paraqitur stafin zbatues qe do te kryej shërbimet neper LOT-et përkatëse. (**shih fakt nr. 5- faqe 18 e DT- ekstraktet përkatëse);**

11. Kompania 'Uni Project' nuk pajtohet me konstatimet e anëtarëve te komisionit per vlerësimin e ofertave ne Raportin e vlerësimit te ofertave se kemi ofruar 'çmim te larte' përkundër faktit qe kemi plotësuar te gjitha kërkesat teknike dhe financiare te Autoritetit Kontraktues.

    Ne këtë drejtim, Kompania 'Uni Project' ka ofruar çmim te tregut per ofrimin e sherbimeve mirëpo per shkak 'mos trajtimit' te ofertës financiare te O.E te shpallur fitues 'MSS' si oferte me çmim abnormalisht te ulte sipas Rregullës B57 është refuzuar padrejtësisht Oferta e Kompanisë 'Uni Project';

12. Ne planin e menaxhimit te O.E te shpallur fitues 'MSS' nuk konstatohet dhe nuk vërehet se ka ofruar minimumin prej 10 punëtorë per LOT apo gjithsej 30 punëtorë per 3 LOT-et, ku ne secilin LOT kërkohen 4 inxhiniere te lemive përkatëse si dhe nga 2 punëtorë kujdestar per një ndërrim (3 ndërrime x 2 punëtorë = 6 punëtorë teknik) per Lot 1, Lot 2 dhe Lot 3, ashtu siç është kerkuar me dosje te tenderit gjegjësisht me specifikacionet teknike te detyrueshme.

    Mungesa e përcaktimit te numrit përfundimtar te personelit konsiderohet shkelje e specifikacionit teknik te detyrueshëm, si pjese perberese e Dosjes se Tenderit dhe si e tille duhet te trajtohet si nga Eksperti Teknik dhe nga Paneli Shqyrtues i Organit Shqyrtues te Prokurimit shkelje ligjore duke e konstatuar ligjërisht qe Oferta e O.E te shpallur fitues 'MSS' është Oferte e papërgjegjshme (**shih fakt nr.6 – Plani i Menaxhimit te O.E fitues 'MSS'**);

13. Ne ofertën e O.E te shpallur fitues vërehen disa kontrata te inxhinierëve qe kane kontrata pune si me O.E fitues 'MSS' edhe me Kompani tjera private dhe publike (si Kompania 'REXHA' dhe PTK) dhe si rrjedhoje këta Inxhinierë te propozuar si per Lot 1, Lot 2 dhe Lot 3 nuk

mund te shërbejnë ne te njëjtën kohe dhe ne te njëjtin vend ne 2 kompani private gjegjësisht publike gjate orarit zyrtar ne lokacione te ndryshme te ndërtesave qeveritare.
Prandaj, me Ligjin e Punës por edhe me aktet tjera nënligjore nuk lejohet qe 1 person te këtë dy vende te punës ne te njëjtin orar zyrtar te punës per disa projekte publike ose private njëkohësisht. Poashtu ky veprim i OE MSS bie ne kundërshtim edhe me Paragrafin 4 te Specifikacioneve teknike te detyrueshme (fq 27 e DT) ku kërkohet qe shërbimi te ofrohet ne mënyrë te plote prej orës 8:00-16:00 (**shih fakt nr.7 – Ekstrakt i fq 27 i DT per orarin e punës ne ndërtesat qeveritare)**

Propozimi i inxhiniereve te tille per Lot 1, Lot 2 dhe Lot 3, te tenderit te larterpermendur, është ne kundërshtim edhe me specifikacionet teknike te detyrueshme, per arsye se Autoriteti Kontraktues ka kerkuar qe OE per te implementuar kontratën duhet te kenë ne dispozicion personelin e kerkuar ne orarin zyrtar te punës se Institucioneve Publike te Kosovës per te përballuar te gjithë punën voluminoze per implementimin e projektit ne te gjitha ndërtesat e specifikuara per 3 Lotet e lartpërmendura;

14. Ne nderlidhshmeri, me piken 13, te kësaj Kërkese per Ri-shqyrtim, Kompania 'Uni Project' kërkon si nga Eksperti Shqyrtues por edhe nga Paneli Shqyrtues qe per shkak shkeljes se dispozitave ligjore te Ligjit te Punës por edhe specifikacioneve teknike te detyrueshme, si pjese perberese e Dosjes se Tenderit qe personeli i propozuar nga Operatoret Ekonomik te jete i pranishëm gjate tere orarit zyrtar te punës te konsideroje Ofertën e O.E te shpallur fitues 'MSS' te papergjegjeshem per shkak mos plotësimit te kërkesave teknike / profesionale te potencuara ne nenin 9.1 dhe 9.2 te Fletës se te Dhënave te Tenderit si ne vijim:

Emri dhe Mbiemri	**Mosha**	**Paga**	**Titulli dhe Vendi i Punës**
1. Naser SURDULLI	54	150 netto	IDA, REXHA Company dhe MSS
2. Arsim NAZIFI	34	200 netto	Bachelor Ing. Mak, MSS
3. Berat HASANAJ	32	300 netto	Bachelor Ing. Elek, REXHA Company MSS
4. Skender ROGOVA	51	150 netto	IDE, PTK dhe MSS
5. Burim HASANAJ	30	150 netto	Bachelor Ing. Nder, REXHA Company MSS
6. Flamur SELMANAJ	30	300 netto	Bachelor Ing. Mak, MSS
7. Ardian MIFTARAJ	25	300 netto	Bachelor Ing. Elek, MSS
8. Dukagjin RAMQAJ	30	250 netto	Master Ing. Elektronikes, MSS
9. Valmir KRASNIQI	29	300 netto	Bachelor Ing. Ndert. MSS
10.Besnik BALAJ	52	250 netto	Bachelor Ing. Mak, MSS
11.Luljeta BABUNI	59	250 netto	IDE, REXHA shpk dhe MSS 5/3
12.Avdi Avdiu	41	300 netto	Bachelor Ing. Elek, MSS

(**shih fakt nr. 8 - Kopjet e kontratave te inxhiniereve, dhe dokumentet përcjellëse te tyre**);

15. Kompania UNI-PROJECT konsideron shkelje serioze te Vendimit te Qeverise nr 4/33 te datës 17.08.2011, Paragrafi 1.2 ku ceket se te gjithë te punësuarit mbi moshën 35 vjeçare paga minimale duhet te jete minimum 170.00 Euro. Ne dosjen e personelit te propozuar nga OE MSS kemi vërejtur se ka paraqitur kontrata me persona te cilët kane moshën mbi 35 vjeç kurse paga e tyre është nen 170.00 Euro, gjegjësisht 150.00 Euro. (**shih fakt nr. 9 - vendimi i Qeverise se Kosovës i datës 17.11.2011); dhe**

16. Kompania 'Uni Project' gjate procesit te prokurimit me datën 22 / 12 / 2016, i është drejtuar me shkrese zyrtare Ministrisë se Administratës Publike gjegjësisht Departamentit te Prokurimit per te kerkuar sqarime zyrtare duke përdorur formën e aprovuar nga KRPP-ja mirëpo Autoriteti Kontraktues duke bere shkelje ligjore administrative nuk ka kthyer përgjigje ne pyetet e parashtruara.

Pyetjet kane te bëjnë me kapacitetet ekonomike financiare sa i përket dëshmive rreth qarkullimit vjetor per 3 vitet e fundit dhe ceshtjet per kapacitetin teknik profesional per te ofruar sqarim per 'shërbime te njëjta' (**shih fakt nr. 9 – Kërkesa per sqarime shtese, e datës 22 / 12 / 2016**).

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Kompania 'Uni-Project', me plotësimin e te gjitha kërkesave/kushteve te tenderit ka interes te caktuar materialo-juridik ne parashtrimin e Ankesës dhe ka qene Ofertuesi potencial per fitimin e kontratës publike.

Vendimi i Ministrisë se Administratës Publike por edhe te anëtarëve te komisionit per vlerësimin e ofertave ka dëmtuar rende interesat materiale financiare te Kompanisë sonë per mos fitimin e një Kontrate publike ne mënyrë te rregullte dhe te drejte, e qe garantohet me Ligjin e Prokurimit dhe Kushtetutën e Kosovës.

Prandaj, mos fitimi i një kontrate publike ne mënyrë te rregullte ndikon ne shpenzime te ndryshme ligjore, largimin e punëtorëve nga puna, humbja e fitimit nga projekti i realizuar, si dhe reputacioni i Kompanisë sonë ne tregun e Kosovës.

PROPOZIM

Duke u nisur nga prezantimi i argumenteve ligjore me arsyetim ligjor ne Ankese, Kompania 'Uni-Project', kërkon nga Paneli Shqyrtues i Organit Shqyrtues te Prokurimit te beje shoshitjen e fakteve ne mënyrë ligjore duke marre **Vendim per te kthyer lenden e kontestuar ne RI-VLERESIM te Ofertave** ne mënyrë qe te detyrohet Autoriteti Kontraktues – Ministria e Administratës Publike, te beje Vlerësim te drejte dhe objektiv te ofertave gjate procesit te serishëm dhe te Ri te vlerësimit te ofertave me anëtar te rinj te komisionit per vlerësimin e ofertave.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*